

Shumica e mësimeve dhe instruktorëve në shkollat e mesme profesionale, posedojnë njohuri solide, profesionale teorike dhe shkathtësi profesionale praktike.

Shumica dërmuese posedon shkollim profesional të inxhinierisë teknike, përvojë pune, gjë që dëshmon një kompetencë të lartë profesionale.

Për aplikim kuptimplotë të një Curriculumi të ri, çdo instruktor duhet të ketë njohuri solide didaktiko - metodike - kompetencë metodash.

Doracaku përmban detyra, këshilla si dhe nxitje për një prezentim interesant dhe të llojllojshëm të metodës mësimore teorike dhe praktike. Por, doracaku assesi nuk ka për qëllim zëvendësimin e përgatitjeve dhe të ideve kreative personale.

Në të ardhmen, detyra e instruktorit do të jetë përkrahja edhe më intenzive se deri më tani e procesit mësimor, e jo udhëheqja. Ligjëratat gjithnjë e më tepër do të zëvendësohen me këshilla, në vend të ligjëritimit të përmbajtjes do të kemi procese mësimore aktive.

Andaj, ndër të tjera, qëllimi i këtij doracaku është edhe përgatitja e instruktorit në rolin e ri, si këshilltar mësimor, në mënyrë që të forcojmë kompetencat e tij të veprimit social. Ora mësimore, në të cilën nxënësi rrallëherë mirrte fjalën, duhet ti takoj të kaluarës.

Nxënësit të cilët e përfundojnë shkollimin e tyre në shkollat e mesme profesionale, duhet të kenë aftësi për të kuptuar varësitë e rëndësishme për profesion si dhe të zotërojnë shkathtësitë e nevojshme.

Duhet të jenë në gjendje që vetë ti zgjedhin problemet, të jenë komunikativë dhe kooperativë si dhe të shprehen qartë dhe kuptueshëm.

Vetëm nga këto pikëpamje, ky doracak i arsyeton pretendimet e tij.

Në kapitullin vijues ju shoqëron një zonjushë që është e angazhuar aplikimin e Curriculum -it të ri.

Ajo e njih gjendjen reale në shkolla: Ora mësimore zhvillohet tërësisht në mënyrë frontale, mësimdhënësi mban një ligjëratë në formë të komprimuar. Shumë pak përdoren momente relaksuese, si p.sh. planifikimi dhe përgatitja interesante e hyrjes në procesin mësimor.



*Mirëdita, unë quhem VALBONA!*

*Të fillojmë menjëherë me më të rëndësishmet - Përgatitja e orës sonë mësimore.*

*Njeriu nuk mundet të detyrojë arritjen e suksesit të një ore mësimore. Mirëpo, korniza mësimore mund të ketë aso forme që të jetë interesante dhe e llojllojshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.*

*Ndonëse pjesë e vogël, përgatitja me shkrim e orës mësimore paraqet një pjesë të rëndësishme të përgatitjes së përgjithshme. Nevojitet shumë kohë dhe mund, por rezultatet e arritura flasin në favor të saj.*

*Qëkur bëjë përgatitjen me shkrim të orës mësimore, interesimi i nxënësve të mi gjatë procesit mësimor dukshëm është shtuar!*

*Përdoreni përgatitjen në vijim si nxitje për mësimin e juaj, praktiko - profesional!*

*(Sqarimet didaktiko - metodike në kapitullin 9)*

## **KUJDES!**

**Ju lutem mos pritni një orë mësimore të qetë, nëse i merrni parasysh rregullat e ofruara!**

**Është mëse e sigurt se nxënësit e trajtuar në këtë mënyrë do të jenë më kritik, të hapur, jo të qetë dhe më kurrështarë për njohuri!**